

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DHOMA E NOTERISE – TIRANE
Nr.....449.....REP

Notere Gentiana SHKODRA
A. Toptani, Torre Drin, No.32
Tel. 2271576
Nr.....200.....KOL



AKTI THEMELIMIT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SAHRA TOURS” SHPK (ne zbatim te ligjit n. 9901 date 14.04.2008)

me seli ne Tirane

Ne Tirane, sot me date 26.03.2018, para meje u paraqit:

Z. Nazmi KURTI, biri i Alushit dhe Qeres, lindur ne Bastar, Tirane, me 13.03.1987, banues ne Bashkia Kamez, Kodi Postar 1054, Bathore, Rruga “Vora”, nr.3, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. BB6076841 / I70313132R

ne cilesine e ortakut te Shoqerise “SAHRA TOURS” SHPK.

perpilon

sa me poshte vijon:

1) I lartpermenduri deklaroi se themelon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin shoqeror: “SAHRA TOURS” Sh.p.k., me seli ne adrese: Bashkia Kamez, kodi postar 1054, Bathore, Rruga “Vora”, nr.3.

2) Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj:

- Sherbime me qellim promovimin dhe nxitjen e turizmit
- Organizimi i tureve te ndryshme turistike brenda dhe jashte vendit dhe guida turistike.
- Promovimi i turizmit te detit, te malit, kulturor, arkelologjik e historik.
- Zhvillimi i panairove, seminareve dhe work-shopeve ne fushen e turizmit.
- Tregetimi me pakice i biletave te avioneve, anijeve dhe autobuseve.
- Rezervim dhe akomodim hotelier.
- Ofrim paketa turistike
- Ofrim paketa udhetimi per Haxh dhe Umera (udhetime me natyre religjioze)
- Ndermjetesim konsullor dhe pergatitje dokumentacioni te nevojshem per udhetime e klienteve
- Marrje/ dhenie me qira apo blerje e pasurive te paluajtshme ose te luajtshme, shprehimisht automjete, qe do t'i sherbejne permbushjes se qellimeve te mesiperme.
- Cdo aktivitet tjeter, qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartpermendura.

3) Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar.

4) Kapitali shoqeror eshte leke 1.000 dhe i nenshkruar plotesisht nga ortakut i vetem i shoqerise.

5) Kapitali shoqeror eshte i perbere nga 1 kuote, e mbajtur nga ortakut i vetem i shoqerise.

6) Shoqeria do te administrohet nga administratori i vetem te cilit i jane dhene te gjitha kompetencat e drejtimit te zakonshem.

Administratori i vetem qendron ne detyre per nje mandat 5 – vjecar dhe per sa kohe nuk eshte revokuar nga ortakut i vetem si organi me i larte vendimmarres ne shoqeri.

Me kete akt, administrator i pare dhe i vetem i shoqerise emerohet Z. Nazmi KURTI.

7) Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 2018.

8) Vendbanimi fiskal i ortakut te vetem do te jete selia e shoqerise per cdo efekt ligjor.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare me vlere te njejte ligjore.


Shoqeria krijohet dhe do te ushtroje aktivitet ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi, ligjit n. 9901 date 14.04.2008 dhe ligje te tjera qe do te jene ne fuqi gjate periudhes se aktivitetit te shoqerise, si dhe ne perputhje me statutin qe konsiderohet pjese perberese e ketij akti dhe qe i bashkengjitet si ANEKSI B.

Lexuar, gjetur konform vullnetit te lire e te pavesuar, pranuar dhe nenshkruar nga ortakut i shoqerise ne pranine e noterit:

ORTAKU I SHOQERISE:

Nazmi Kurti 
NAZMI KURTI

Deklaroj une notere Gentiana Shkodra se dhashe asistencen ligjore dhe perpilova aktin e themelimit si me lart dhe se themeluesit, per identitetin e te cileve jam e bindur, nenshkruan rregullisht para meje, ne thember te aktit te mesiperm. E legalizoj aktin sipas ligjit. Prodhuar ne pese ekzemplare me vlere te njejte ligjore.


GENTIANA SHKODRA / Notere

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SAHRA TOURS” SHPK

(ne zbatim te ligjit n. 9901 date 14.04.2008)

me seli ne Kamez

Ne Tirane, sot me date 26.03.2018, une i nenshkruari:

Z. Nazmi KURTI, biri i Alushit dhe Qeres, lindur ne Bastar, Tirane, me 13.03.1987, banues ne Bashkia Kamez, Kodi Postar 1054, Bathore, Rruga “Vora” , nr.3, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. BB6076841 / I70313132R

perpiloj kete statut te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar si me poshte vijon:

KREU I **Emertimi - objekti,** **Selia – Afati** **Neni 1**

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin social “SAHRA TOURS” Sh.p.k. me ortak te vetem Z. Nazmi KURTI.

Emertimi i shoqerise do te shfaqet ne te gjitha aktet qe do te dalin ne emer dhe per llogari te shoqerise. Ne kete statut shoqerise se lartpermendur do t'i referohemi si “Shoqeria”.

Neni 2

Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj:

- Sherbime me qellim promovimin dhe nxitjen e turizmit
- Organizimi i tureve te ndryshme turistike brenda dhe jashte vendit dhe guida turistike.
- Promovimi i turizmit te detit, te malit, kulturor, arkelologjik e historik.
- Zhvillimi i panairove, seminareve dhe work-shopeve ne fushen e turizmit.
- Tregetimi me pakice i biletave te avioneve, anijeve dhe autobuseve.
- Rezervim dhe akomodim hotelier.
- Ofrim paketa turistike
- Ofrim paketa udhetimi per Haxh dhe Umera (udhetime me natyre religjioze)
- Ndermjetesim konsullor dhe pergatitje dokumentacioni te nevojshem per udhetime e klienteve
- Marrje/ dhenie me qira apo blerje e pasurive te paluajtshme ose te luajtshme, shprehimisht automjete, qe do t'i sherbejne permbushjes se qellimeve te mesiperme.



- Cdo aktivitet tjeter, qe lidhet direkt apo indirekt me aktivitetet e lartpermendura.

Neni 3 Selia

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Bashkia Kamez, Kodi Oostar 1054, Bathore, Rruga "Vora", nr.3.

Ortaku i Vetem ose Asambleja e ortakeve, nese shoqeri do te kete me shume s enje ortak ne te ardhmen, ka te drejte te hape seli te tjera sekondare, filiale, zyra perfaqesimi dhe agjensi si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj, madje dhe te transferoje seline e shoqerise, por kjo e fundit gjithesesi do te mbetet ne territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 4- Adresa

Adresa zyrtare e ortakeve per cdo marredhenie lidhur me shoqerine eshte adresa qe do te rezultoje nga libri i ortakeve.

Neni 5 - Kohezgjatja e veprimtarise

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar dhe pa afat, por shoqeria mund t'e shperbehet ne cdo moment me vendim te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

Neni 6- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000 (njemije) leke dhe mund te rritet ne baze te modaliteteve ligjore.

Neni 7- Vlera e kuotave dhe pjesemarrja

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 (nje) kuote, e mbajtur nga ortaku i vetem i shoqerise.

Neni 8- Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndaj te treteve, ose dhe ndermjet ortakeve, nese shoqeria do te kete me shume se nje ortak. Transferimi i kuotave ndaj te treteve - jo ortake, ne cdo rast, do t'i nenshtrohet respektimit se te drejtes se parablerjes. E drejta e parablerjes i perket cdo ortaku, ne proporcion me kuotat e mbajtura dhe duhet te ushtrohet brenda 30 diteve nga oferta e njoftuar nga ortaku qe ka vullnet per shitjen e kuotave. Oferta duhet te njoftohet me poste te regjistruar dhe marrja duhet te jete konfirmuar.

Ne rast mosekzekutimi te se drejtes se parablerjes brenda 30 diteve nga oferta, kuotat mund t'i transferohen paleve te treta.

Neni 9 – Rritja e kapitalit

Ne rast rritje te kapitalit, kontributet do te ofrohen nga ortaket ne proporcion me kapitalin e poseduar prej secilit prej tyre.

Neni 10 – Financimet

Financimet e bera nga ortaket, ne proporcion me kuotat e mbajtura dhe ne perputhje me vendimet e asamblese, jane te lira nga interesat.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABEL

Neni 11 – Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Ortaku i Vetem ose Asambleja e ortakeve, nese shoqeri do te kete me shume se nje ortak.

11.2 Vendimet e Asamblese se Shoqerise, per te cilat kerkohet nje shumice e thjeshte, jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne sa paku 31 (tridhjetë e nje) % te te gjithe kapitalit themeltar.

11.3 Vendimet e Asamblese se Shoqerise, per te cilat kerkohet nje shumice e kualifikuar, jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te pakten 51 (pesedhjetë e nje) % te gjithe kapitalit themeltar.

Neni 12 – E drejta e pjesemarrjes se votes

12.1 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamble dhe te paraqese mendimin e tij dhe te jape aq vota sa eshte numri i kuotave te kapitalit qe ai zoteron.

12.2 Cdo ortak ka te drejte qe te perfaqesohet nga nje person tjeter dhe jo-ortak, i pajisur me prokure me shkrim, me anen e se ciles do te jape voten e tij.

12.3 Ortaku nuk mund te leshoje prokure per votim per nje pjese te kuotave te kapitalit qe ai zoteron, ne qofte se voton personalisht per pjesen e mbetur te kuotave.

Neni 13- Thirrja e asamblese se Ortakeve

13.1 Asambleja e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e bilanci, te raportit te Administratorit, ekspertit kontabel si dhe inventarit.

13.2 Asambleja mund te thirret ne cdo moment nga nje prej administratoreve ose nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se 5 % te kapitalit themeltar.

13.3 Asambleja duhet te thirret nepermjet njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje qe duhet t'u dergohet ortakeve ne adresen qe rezulton ne Librin e Ortakeve dhe ekspertit kontabel, nese eshte emeruar, te pakten 7 dite para mbledhjes se

Asamblese. Thirrja duhet te permbaje informacion mbi llojin e Asamblese, si dhe ceshtjet qe do te trajtohen dhe per te cilat do te merret vendim, mbi vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte.

13.4 Asambleja mund te thirret dhe jashte selise se shoqerise, ne Shqiperi ose jashte saj.

13.5 Mbledhjet e Asamblese mund te mbahen dhe nepermjet telekonferences dhe videokonferences, me kusht qe te gjitha pjesemarresit te mund te identifikohen dhe t'i lejohet te ndjekin diskutimin dhe te nderhyjne ne momentin e trajtimit te argumenteve, pasi te jene verifikuar keto kerkesa qe duhet te rezultojne ne procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet ne vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

13.6 Asambleja do te thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve te njoftimit, ne rast se jane te pranishem ortaket qe perfaqesojne te tere kapitalin themeltar.

13.7 Cdo Asamble do te drejtohet nga nje ortak ose ndonje person tjetër i caktuar nga e njejta Asamble. Per pasqyrimin e vendimit, Asambleja emerone nje sekretar, qe mund te jete dhe jo-ortak.

13.8 Vendimet e Asamblese duhet te nenshkruhen nga Kryetari i Asamblese dhe Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

14.1 Shoqeria administrohet nga 1 (nje) administrator, i cili qendron ne detyre deri ne revokim apo doreheqje, per nje periudhe maksimale prej 5 (pese) vjetesh.

14.2 Perfaqesimi ligjor do t'i besohet administratorit **Z. Nazmi KURTI**, biri i Alushit dhe Qeres, lindur ne Bastar, Tirane, me 13.03.1987, banues ne Bashkia Kamez, Kodi Postar 1054, Bathore, Rruga "Vora", nr.3, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes nr. BB6076841 / I70313132R.

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat sipas parashikimeve te nenit 95 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

14.3 Administratori mund te emeroje perfaqesues te posacem per akte te vecanta ose per kategori aktesh.

Neni 15- Eksperti kontabel i autorizuar

15.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakeve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabel te shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar.

15.2 Eksperti kontabel i licensuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

KAPITULLI IV



VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 16

16.1 Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit.

16.2 Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregetar dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.

16.3 Bilancet vjetore, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar, nese eshte emeruar, miratohen nga Asambleja me shumicen e percaktuar sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

16.4 Miratimi i dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 muajve nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% te destinuar per rezerven ligjore deri ne 10% te kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu te gjitha shumat qe Asambleja vendos te vere menjane, u shperndahen ortakeve ne proporcion me kuotat e kapitalit themeltar te zoteruara.

17.2 Asambleja mund te vendose dhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo per shtyrjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht ose pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme.

KAPITULLI V

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 18 – Prishja

18.1 Shoqeria priset me ane te Vendimit te Asamblese se Ortakeve, me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar, pazotesise juridike, vdekjes ose falimentimit te njerit ose disa ortakeve.

Neni 19 – Likuidimi

19.1 Ne rast prishje, shoqeria duhet te likuidohet.

19.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja emeron nje ose me shume likuidatore, te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivit te shoqerise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshem per te perfunduar likuidimin.

19.3 Me perfundimin e procedures se likuidimit, Asambleja do te vendose mbi bilancin financiar perfundimtar, mbi punen e kryer nga likuiduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likuidimit.

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do te shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve, ne proporcion me kuotat e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 20- Zgjidhja e mosmarreveshjeve

20.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij satuti dhe aktit te themelimit, si dhe ato qe mund te lindin ne pergjithesi midis ortakeve (pervec atyre personale dhe jashte shoqerise) ose midis nje apo me shume ortakeve te shoqerise, do te zgjidhen ne menyre miqesore dhe do te diskutohen ne menyre te drejteperdrejte ndermjet paleve te interesuara.

20.2 Ne rast se nuk arrihet nje zgjidhje miqesore te mosmarreveshjes, ato do t'i besohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 21 – Gjuha

21.1 Ky statut eshte i perbere nga 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe.

Lexuar, gjetur konform vullnetit te lire e te pavesuar, pranuar dhe nenshkruar nga ortaku themelues ne pranine e noterit:

ORTAKU THEMELUES

Nazmi Kurti + i 
NAZMI KURTI